

URDHËR
Nr. 391, datë 1.8.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 2.8.2022–14.8.2022, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 388, datë 29.7.2022, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja